



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Disa mendime lidhur me Rekomandimet e OSBE/ODIHR-it
Për Zgjedhjet e 28 Qershorit 2009



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Pjesa e I

Disa mendime lidhur me Rekomandimet e OSBE/ODIHR-it të dt.14 Shtator 2009 për Zgjedhjet Parlamentare të 28 Qershorit 2009

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), si një ndër organizatat monitoruese të zgjedhjeve parlamentare të 28 Qershorit 2009, ka studiuar me vëmendje rekomandimet e OSBE/ODIHR-it. KShH. Për të mundësuar zbatimin më të mirë të tyre dhe për të dhënë kontributin e tij modest në këtë drejtim, ka kohë që ka përgatitur sugjerimet e tij.

Këto sugjerime do t'i dërgoheshin Komisionit Parlamentar përkatës që mendohej të ngrihej për këtë qëllim. Por për arsye që dihen, ky Komision ende nuk është ngritur, deri më sot.

Pavarsisht nga kjo, duke patur parasysh se zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 8 Majit 2011 po afrojnë, me shpresën se ky Komision mund të ngrihej qoftë edhe për rregullime të pjesshme dhe të domosdoshme në Kodin Zgjedhor, KShH mendoi të bëjë publike disa mendime që mund t'iu shërbenin qoftë edhe për disa shtesa apo ndryshime në dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor.

E pamë të arsyeshme të përqëndrohemi kryesisht në rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, edhe pse sipas mendimit tonë, Kodi Zgjedhor duhet të shikohet edhe në drejtime të tjera, çka do të kërkonte një diskutim dhe debat më të thelluar dhe gjithëpërfshirës. Kushte më të favorshme për realizimin e këtij procesi mendojmë se mund të krijoheshin mbas zgjedhjeve të dt.8 Maj 2011.

*

*

*



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Raporti i OSBE/ODIHR-it, i dt.14 Shtator 2009, lidhur me zgjedhjet e 28 Qershorit 2009, përmban 31 rekomandime që përfshihen në kapitujt: Partitë Politike; Kuadri Ligjor; Administrimi i Zgjedhjeve; Regjistrimi dhe Identifikimi i Zgjedhësve; Regjistrimi i Kandidatëve; Fushata Zgjedhore; Media, Votimi; Numërimi; Përmbledhja dhe Shpallja e Rezultateve; Ankesat dhe Kërkesë-Paditë; Pjesëmarrja e Grave; Pjesëmarrja e Pakicave Kombëtare.

KShH e konsideroi të nevojshme të ndalet në rekomandimet e mëposhtme:

- 1) OSBE/ODIHR-i rekomandin që “partitë politike duhet të tregojnë vullnet politik për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike” dhe më pas vijon “kjo vlen edhe për performancën e komisioneve zgjedhore dhe nëpunësve të zgjedhur dhe të emëruar, të të gjitha niveleve, të cilët nuk duhet t’i mbështesin veprimet dhe vendimet e tyre në lidhje me zgjedhjet, me çështje apo bindje politike”. Ndërsa në vazhdim të këtij rekomandimi, në kapitullin “Administrata Zgjedhore” theksohet se: “Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet me qëllim që të eliminohet çdo lloj mundësie për abuzim apo bllokim të procesit nga partitë politike”. Përsa i përket Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ-së) theksohet se: “Kur është e nevojshme, KQZ-ja duhet të përdorë më shumë autoritetin e saj të gjerë që i jep Kodi Zgjedhor, sidomos kundrejt Komisioneve Zgjedhore të nivelit më të ulët ... KQZ-ja duhet të jetë më proaktive në hetimin dhe zgjidhjen e këtyre problemeve”.

Nëse do t’i hidhej një sy raporteve të mëparshme të OSBE-ODIHR-it në këtë drejtim, janë bërë thujtë të njëjtat rekomandime. Në këto raporte është përmendur mungesa e vullnetit politik, ndërhyrja e partive politike (subjekteve zgjedhore) në veprimtarinë e komisioneve zgjedhore, moskryerja në mënyrë të pavarur dhe të paanshme të detyrave të tyre të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, etj.

Janë pikërisht këto arsye, që si më parë edhe tani, sidomos nga disa parti të vogla politike të pozitës dhe opozitës është ngritur çështja e përbërjes të komisioneve zgjedhore duke filluar nga KQZ-ja, jo me anëtarë të propozuar nga partitë përkatëse politike, por me persona të tjerë që japin më tepër garanci në zbatim të ligjit dhe mosnënshtrim ndaj ndërhyrjeve apo presioneve partiake.

Ky është një sugjerim që mendojmë se vlen të diskutohet edhe pse zgjidhja e tij nuk është e lehtë, veç të tjerave edhe për kohën relativisht të shkurtër deri në 8 Maj të këtij viti.

Ka mendime se, meqë dobësitë më të mëdha janë vërtetuar në komisionet më të ulëta, ndryshime duhet të bëhen vetëm në përbërjen e tyre.

Në fakt, nëse do t’i referoheshim raportit të OSBE/ODIHR-it, lidhur me zgjedhjet e 28 Qershorit 2009, bëhet e qartë se edhe nga vetë KQZ-ja janë mbajtur qëndrime të politizuara dhe pasive. Kështu psh, në raport thuhet se: “KQZ-ja shpesh u nda sipas bindjeve politike, mazhorancë – opozitë, veçanërisht në çështjet më të debatuar. Mbledhjet e KQZ-së, shpesh u karakterizuan pa qenë nevoja nga interpretime të gjata dhe të përsëritura të ligjit dhe deklarata personale dhe politike, parashtruar si nga anëtarët e KQZ-së, ashtu edhe nga përfaqësuesit e partive”.

Lidhur me sa më sipër në raport konkludohet se: **“Ky politizim pati ndikim mbi punën e KQZ-së, veçanërisht në detyrën e saj për të administruar zgjedhjet në një mënyrë asnjëanëse dhe efikase”** (faqe 9).

Në këto kushte, administrimi i zgjedhjeve jo në mënyrë të paanshme (kjo për shkak të politizimit) nuk përjashton mundësinë e vendimarrjeve të njëanshme.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Në rekomandimin nr.10 të raportit të OSBE/ODIHR-it thuhet se: “KQZ-ja duhet të jetë më proactive në hetimin dhe zgjidhjen e këtyre problemeve” (faqe 32). Ky rekomandim është i lidhur me disa konstatime që jepen në raport. Kështu psh, në faqen 9 të raportit thuhet se: “Autoriteti i KQZ-së dhe kontrolli mbi KZAZ-të është i kufizuar. Kjo u bë e diskutueshme ditën e zgjedhjeve dhe veçanërisht gjatë numërimit të votave” ku vijohet me tej “ Shumë prej problemeve që dolën gjatë monitorimit të votave si qasja jo konsistente e KZAZ-ve lidhur me vlefshmërinë e votave, ose bllokimi i procesit të numërimit mbi baza procedurale në disa prej VNV-ve, mund të ishin parandaluar në rast se KQZ-ja do të kishte dhënë më shumë këshillime ligjore, si edhe udhëzime më të plota dhe më specifike”.

Qëndrimet e politizuara dhe pasiviteti në disa raste i KQZ-së ka krijuar shqetësime me pasoja të dëmshme. Mjafton të përmendim rastin e përmendur në raportin e OSBE/ODIHR-it se: “Vëzhguesit e MNVZ-së raportuar praninë e personave të paautorizuar në 49 VNV dhe këta persona ndërhyjnë ose drejtonin procesin në 21 prej tyre ... “ (faqe 25).

Si mund të flitet për numërim të rregullt, të saktë dhe në përputhje me ligjin, kur në 21 QNV, persona të paautorizuar ndërhyjnë apo drejtonin këtë proces?!

Janë pikërisht këto disa nga arsyet që mendojmë se e bëjnë të nevojshme diskutimin për ndryshimin e përbërjes të krejt komisioneve zgjedhore (përfshi edhe KQZ-në) duke përjashtuar propozimet nga partitë politike përkatëse, siç parashikohet në Kodin Zgjedhor në fuqi.

Ashtu siç e përmendëm edhe më lart, zgjidhja e këtij problemi nuk është e thjeshtë. Në këtë drejtim mund të paraqiten variante të ndryshme. Çështja është të kufizohet në maksimum ndikimi partiak. I vështirë mund të ishte krijimi i KQV-ve që janë të shumta në numër. Për këtë mund të diskutohej rritja e numrit të zgjedhësve në listat zgjedhore për çdo qendër votimi, përbërja e KQV-ve me 3-5 anëtarë që të plotësojnë disa kritere (aftësi, arsim, paanshmëri, ndershmëri, integritet etj). Këta mund të ishin juristë (gjyqtarë, avokatë, arsimtarë, aktivistë të shoqërisë civile etj).

Për sa i përket KZAZ-ve, mund të përbëheshin nga 7 – 9 persona, që të ngarkoheshin edhe me numërimin e votave (të mos kishte grupe numërimi të veçanta). Kriteret për caktimin apo zgjedhjen e tyre të ishin më kërkuese dhe nga grupe apo rrethe më të kualifikuara.

Lidhur me KQZ-në mendojmë se mund të ishte si kriter jo vetëm aftësia profesionale, sidomos në fushën e legjislacionit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, por edhe treguesit e tjerë: ndershmëria, integriteti etj. Këta mund të zgjidheshin ose të caktoheshin me short (githmonë në bazë të disa kritereve ligjore) nga rrethe juristësh, gjyqtarësh, avokatësh, noterësh etj, nga institucionet arsimore, akademike, nga shoqëria civile etj. Përbërja e KQZ-së mund të ishte 7 – 9 persona.

Nëse si variant i përbërjes të komisioneve zgjedhore do të pranohej ai që përmendëm më lart, dmth jo me propozim të partive politike, do të duhej të diskutoheshin në detaje modalitetet, mënyra më e përshtatshme dhe më e besueshme (procedura) e caktimit ose zgjedhjes së tyre etj.

Lidhur me këtë çështje, drejtues të disa partive politike dhe individë të veçantë janë shprehur se edhe në disa vende të tjera demokratike, komisionet zgjedhore krijonin sipas propozimeve që bëhen nga partitë politike. KShH mendon se pavarësisht nga kjo, po t'i referohemi zgjedhjeve në vendin tonë, politizimi i komisioneve zgjedhore është shoqëruar me pasoja të dëmshme, gjë që në mënyrë të vazhdueshme siç u përmend edhe më lart, është evidentuar edhe në raportin e OSBE/ODIHR-it.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Ata që mund të kundërshtojnë sugjerimin e mësipërm, mund të arsyetohin se OSBE/ODIHR-it nuk ka bërë ndonjë rekomandim të tillë. Mendojmë se ky nuk është argument. Ka patur dhe ka raste që në rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, konstatohet fakti por nuk jepet varianti apo variantet e zgjidhjes. Propozimet partiake për krijimin e komisioneve zgjedhore me ndonjë rregullim jothelbësor që mund t'i bëhen kësaj apo asaj dispozite të Kodit Zgjedhor, nuk besojmë të eliminojmë fenomenet negative të vërtetuara në veprimtarinë e komisioneve zgjedhore në mënyrë të përsëritur.

Në Kodin e Mirë të Zgjedhjeve të miratuar nga Komisioni i Venecias në vitin 2002, midis të tjerave theksohet se: “Vetëm transparencja, paanshmëria dhe pavarësia nga manipulimi i motivuar politikisht, mund të sigurojë administrimin siç duhet të procesit elektoral, nga periudha paraelektorale deri në fund të përpunimit të rezultateve”. Në fakt, ajo që u ka munguar komisioneve tona zgjedhore, ka qenë mungesa e transparencës, paanshmërisë dhe pavarësisë. Kjo ka ndodhur sepse anëtarët e komisioneve para zbatimit rigoroz të ligjit, i kanë dhënë përparësi udhëzimeve dhe diktimit partiak.

- 2) Në rekomandimin Nr.2 të OSBE/ODIHR-it, kërkohet rishikimi i dispozitës që i jep kryetarëve të partive politike të drejtën e kandidimit. Në pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, thuhet se kryetarët e partive politike mund të kandidojnë në një apo më shumë zona zgjedhore për zgjedhjet në Kuvend. Kjo dispozitë është miratuar me konsensusin e dy partive më të mëdha, pa patur parasysh faktin se kjo çënon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.
- 3) Në rekomandimin Nr.3 thuhet se: “Duhet të eliminohet përfshirja e partive politike në përzgjedhjen e gjyqtarëve që shqyrtojnë ankimmimet zgjedhore”. Ky rekomandim ka të bëjë me nenin 146 pika 3 të Kodit Zgjedhor, ku ndër të tjerash theksohet se: “Mbas zgjedhjes me short të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, dy partive parlamentare të shumicës dhe dy partive parlamentare të opozitës, u jepet e drejta të përjashtojnë një prej 8 emrave të zgjedhur me short, pa treguar shkaqet e përjashtimit”. Në fakt, kjo dispozitë nuk është e re. Ajo është miratuar qysh në vitin 2003. Miratimi i saj u arsyetua me synim rritjen e besimit reciprok, sidomos midis dy partive më të mëdha pa marrë parasysh faktin e cënimit të parimit të pavarësisë të gjyqësorit. Ky interes partiak ka qenë kaq i fuqishëm, aq sa në këtë dispozitë nuk është bërë asnjë ndërhyrje deri më sot, megjithë vërejtjet e bëra nga Komisioni i Venecias dhe OSBE/ODIHR-it qysh në vitin 2004. Veç kësaj, ndërsa në raportet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it rekomandohej rishikimi i nenit 146 pika 3 që u përmend më lart, në raportin e fundit (14 Shtator 2009) përdoret fjalia: “Duhet të eliminohet përfshirja e partive politike në përzgjedhjen e gjyqtarëve që shqyrtojnë ankime zgjedhore. Rekomandimi pra është kategorik, ndryshe nga më parë ku thuhej “të rishikohet”.
- 4) Bashkohemi me rekomandimin Nr.4 të OSBE/ODIHR-it, ku bëhet fjalë për përsëritjen e zgjedhjeve. Është e nevojshme të qartësohen kriteret dhe kushtet në të cilat zgjedhjet në këtë apo atë zonë duhet të përsëriten.
- 5) Shprehim gjithashtu mbështetje edhe për rekomandimin Nr.5, që t'u jepet e drejta e ankimit zgjedhësve, si individë për t'u ankuar në rast se pretendojnë se u janë cënuar të drejtat e tyre. Kështu p.sh, ka patur raste që megjithëse zgjedhësit disponojnë dokument të rregullt identifikimi, ai ose ajo nuk është lejuar të votojë megjithëse



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

disponon vendimin gjyqësor. Gjithashtu, zgjedhësit duhet të kenë të drejtë të ankohen nëse u bëhet presion për të votuar ose për të mos u votuar, ose u është mohuar e drejta e votës megjithëse në momentin e mbylljes së votimit janë të pranishëm në qendrat e votimit. Mendojmë se zgjedhësi duhet të ketë gjithashtu të drejtën e ankimit nëse pretendon se vota e tij (vullneti i tij) është manipuluar etj. Lidhur me zgjedhjet e 28 Qershorit 2009, numri relativisht i pakët i ankesave u konsiderua si element pozitiv. Në fakt, numri i pakët i ankesave mendojmë se u kushtëzua me ndryshimin që u bë në sistemin zgjedhor. Në këtë drejtim kemi parasysh **nenin 124 të Kodit Zgjedhor që u njeht të drejtën e ankimit vetëm partive politike pjesëtare ose jo të një koalicioni si dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit.** Gjithashtu, e drejta e ankimit njihet edhe në rastet kur subjektit përkatës i është refuzuar kërkesa për regjistrim.

- 6) Disa herë, në rekomandimet e OSBE/ODIHR-it është vënë theksi edhe tek dispozitat ku bëhet fjalë për financimin e partive politike. Kemi mendimin se tre janë çështjet kryesore: a) Financimi i tyre në kohë; b) Mosdiskriminimi i partive të vogla (subjekte zgjedhore) b) Kontrolli i të ardhurave dhe shpenzimeve nga një organ i pavarur jashtë ndikimeve partiake dhe jo në varësi të ekzekutivit. Gjithashtu, mendojmë se ky kontroll jo vetëm duhet bërë në fund, d.m.th mbas zgjedhjeve, por në vazhdimësi, në mënyrë të planifikuar ose në bazë të sinjalizimeve.

Vlen të përmendet se çështja e financimit të partive politike është trajtuar edhe në Kodin e Praktikës së Mirë të Zgjedhjeve, miratuar në vitin 2002 nga Komisioni i Venecias. Midis të tjerave në të thuhet se: “Transparenca është në dy nivele: Niveli i parë ka të bëjë me fondet e fushatës të cilat duhet të jenë të detajuara ... Në rastin e devijimeve nga norma ose në rast se tejkalohen kufijtë e detyrueshëm të financimit, zgjedhjet mund të anulohen. Niveli i dytë ka të bëjë me monitorimin e gjendjes financiare të përfaqësuesve të zgjedhur para dhe pas mandatit të tyre. Një komision i ngarkuar për transparencën financiare, mbledh deklaratat e përfaqësuesve të zgjedhur për gjendjen e tyre financiare. Këto deklarata, megjithëse janë konfidenciale, në rast se është e nevojshme, informacioni mund t'i dërgohet prokurorisë” (shih faqen 33, botimi në shqip).

- 7) Asnjëherë trajtimi i anëtarëve të komisioneve zgjedhor dhe të grupeve të numërimit (sidomos të këtyre të fundit) nuk ka qenë në nivelin e duhur. Kjo ka ndodhur për dy arsye: a) Propozimet me vonesë të anëtarëve të këtyre komisioneve; b) Largimet e shpeshta të tyre me kërkesë të subjekteve zgjedhore. Ka shumë mundësi që nëse komisionet zgjedhore nuk do të ngrihen në bazë të propozimeve partiake, trajnimi i tyre do të jetë më cilësor dhe zëvendësimet vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikueshme. Rekomandimi Nr.9 i OSBE/ODIHR-it lidhur me këtë çështje mund ta zbusë disi këtë problem, por nuk e zgjidh atë. Partitë politike do të krijojnë me dhjetëra arsye “të justifikueshme” qoftë për vonesat në propozime, qoftë për zëvendësimin e tyre. Si mund të bëhet ose si mund të pretendohet trajnimi i një numri aq të madh personash të ngarkuar, sidomos me numërimin e votave kur sipas nenit 95 të Kodit Zgjedhor në fuqi ata caktohen 2 ditë para ditës së votimit?! Disa herë është kritikuar një afat kaq i shkurtër për propozimin e tyre, por në praktikë, sidomos dy partitë më të mëdha janë pajtuar me këtë afat me “arsyetimin” se nëse ata do të identifikohen më parë, do të ndikohen apo manipulohen, ose do t'u bëhet presion, etj.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- 8) Lidhur me fushatën zgjedhore ka dy rekomandime të rëndësishme me Nr.16 dhe 17. Në këtë drejtim, në raportin e OSBE/ODHIR-it evidentohen edhe disa shprehje, pjesërisht të vërtetuara. Megjithëse për këto çështje (është fjala për presione gjatë fushatës, keqpërdorim të burimeve administrative etj) organizatat joqeveritare dhe monitoruese të zgjedhjeve e kanë ngritur zërin, madje ato janë trajtuar edhe në media, KQZ-ja ka mbajtur qëndrim indiferent, nuk ka vlerësuar sinjalizimet, nuk ka marrë masa parandaluese, nuk ka zbatuar dispozitat e Kodit Zgjedhor që në këto raste parashikojnë sanksione. Në këtë vështrim, mendojmë se nuk kanë munguar ligjet dhe aktet nënligjore që përgjegjësit e këtyre shkeljeve të viheshin para përgjegjësisë.
- 9) Në raportin e OSBE/ODHIR-it lidhur me median, janë paraqitur 3 rekomandime. Mbështesim rekomandimin që bordi të mos zgjidhet nga KQZ-ja, siç parashikon neni 85 pika 5 e Kodit Zgjedhor, sepse në këtë mënyrë mund të ketë ndikime personale dhe të linjave politike. Institucionet e pavarura të medias, ku përfshihet edhe unioni i gazetarëve, mund të ishin më të përshtatshme, por për këtë është e nevojshme të caktohen disa kritere si dhe mënyra e përzgjedhjes (aftësia, përvoja, integriteti). Jemi gjithashtu dakord me një përkufizim më të qartë të nenit 84 “b” të Kodit Zgjedhor, ku bëhet fjalë për pasqyrimin e veprimtarive qeveritare.
- 10) Rekomandimet që paraqiten në raportin e OSBE/ODHIR-it (Nr.26 dhe 27) i konsiderojmë gjithashtu të rëndësishme. Është e nevojshme që të mos lejohen abuzime dhe keqinterpretime lidhur me kutitë e votimit dhe kutitë me materialet zgjedhore që fillimisht janë konsideruar të rregullta, por që më vonë kanë rezultuar me probleme. Në raste të tilla, jo vetëm duhet të informohet menjëherë KQZ-ja, por edhe të ndjekë mënyrën e zgjidhjes të çështjes. Kur është rasti, KQZ-ja duhet të ndërhyjë që procesi të mos bllokohet.
Veç sa më sipër, rishikimi i nenit 123 të Kodit Zgjedhor (shih rekomandimin Nr.27) është i rëndësishëm sespe votat që numërohen pas një hetimi administrativ (në këtë drejtim në zgjedhjet e 28 Qershorit 2009 ka patur të meta, dhe deri në një farë mase edhe pasivitet nga ana e KQZ-së) duhet të përfshihen në tabelat përmbledhëse të Rezultateve.
- 11) Rekomandimi Nr. 29 i OSBE/ODHIR-it, ku bëhet fjalë për ankesat dhe kërkesë paditë, mendojmë se është i drejtë dhe duhet patur parasysh duke e reflektuar në ligj. Konkretisht, nëse konstatohen shkelje të rënda të ligjit ose shkaqe të tjera që tregojnë se rezultati është cënuar rëndë, nuk ka arsye të hezitohet për të vendosur shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në qendra votimi duke proceduar në rinumërim të mundshëm. Çdo tërheqje në këtë drejtim, apo çdo qëndrim subjektiv dhe i njëanshëm mund të lëkundë besimin e subjektit apo subjekteve përkatëse zgjedhore, gjë që mund të shoqërohej me pasoja të dëmshme.
- 12) Edhe rekomandimi ku bëhet fjalë për respektimin e përqindjes së kandidimit të gjinisë tjetër (gruas), mendojmë se është i drejtë. Pika 5 e nenit 67 të Kodit Zgjedhor duhet të rishikohet dhe kërkesat si në zgjedhjet për Kuvendin, edhe ato për organet e qeverisjes vendore duhet të verifikohen. Kjo do të thotë se në çdo treshe të listës shumëemërore, një të jetë i gjinisë tjetër (grua). Nëse kjo kërkesë nuk plotësohet, në të dy rastet, lista shumëemërore mendojmë se duhet të kthehet për korigjim, ose sipas rastit edhe për zbatim të sanksioneve.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- 13) Lidhur me rekomandimin Nr.24 dhe 25 të OSBE/ODHIR-it, ku bëhet fjalë për të drejtën e kandidatëve dhe të vëzhguesve për të vëzhguar numërimin e votave në mënyrë të barabartë dhe të saktë. Ky është një problem, sa i rëndësishëm, aq edhe delikat që kërkon zbatim rigoroz të ligjit dhe transparencë. Në të kundërt kjo mund të jetë shkas për mosmarrëveshje, acarim të klimës politike, mosbesim dhe kontestim të zgjedhjeve.
- OSBE/ODHIR-i, në raportin e tij ka evidentuar shkelje të rëndësishme në procesin e numërimit të votave (shih fq 25-26 të raportit). Kështu p.sh, në faqen 26 të këtij raporti thuhet se sistemi i ri i monitorimit duket se ka kontribuar vetëm pjesërisht në transparencën e procesit, por nuk zgjidhi problemet e ndërhyrjeve të vëna re si në këto zgjedhje edhe në zgjedhjet e mëparshme.
- Duke patur parasysh shkeljet e konstatuara nga vëzhguesit ndërkombëtarë, por pjesërisht edhe nga vëzhguesit vendas, nëse do të zbatohet monitorimi me kamera, do të sugjerohet:
- Nga pikpamja e funksionimit teknik, duhet që ky system t'i nënshtrohej ekspertimit paraprak për të konfirmuar saktësimin dhe qartësimin e tij. Ky verifikim duhet të zhvillohej në prani të KQZ-së, të specialistëve përkatës dhe të përfaqësuesve të subjekteve zgjedhorë. Në përfundim, veprimet e kryera dhe rezultati duhet të pasqyrohej në procesverbalin përkatës.
 - Në procesin e numërimit të votave, kandidatët dhe vëzhguesit duhet të kenë të gjitha mundësitë për të parë qartë dhe saktë këtë proces.
- 14) Kontestimet e mundshme jo vetëm duhet të pasqyrohen në procesverbal, por procesi i numërimit duhet të pezullohet deri në momentin kur problemi të sqarohet dhe teknika e monitorimit me kamera të ishte efiçente, e plotë dhe pa ndërprerje. KQZ-ja në raste të tilla, jo vetëm duhet të informohet, por edhe të garantonte ecurinë normale të këtij procesi të rëndësishëm.
- Veprime të tilla, mendojmë se duhet të gjenin pasqyrim në dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor.
- Gjithashtu mendojmë se është i drejtë edhe Rekomandimi Nr.15 i OSBE/ODHIR-it që ka të bëjë me depozitimin e nënshkrimeve mbështetëse, përpara një noteri apo në KQZ. Lidhur me pengesat që paraqet procedura e konfirmimit të nënshkrimeve para noterit, një nga partitë politike i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese të shprehet lidhur me kushtetueshmërinë e kësaj dispozite. Prandaj del nevoja e njohjes me përmbajtjen e këtij vendimi, gjë që do të ndihmonte në formulimin e drejtë të nenit 71 të Kodit Zgjedhor. Duhet pra, të kihet parasysh edhe vendimi Nr.32, datë 15/12/2009 i Gjykatës Kushtetuese. Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese të shfuqizojë si të papajtueshëm me Kushtetutën neni 68 dhe neni 71 i Kodit Zgjedhor. Gjykata Kushtetuese ka vendosur shfuqizimin e fjalisë që përmban neni 68 i Kodit ku thuhet se: “Listat e kandidatëve për Kuvendin, të paraqitura nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandate në Kuvend, duhet të mbështeten nga jo më pak se 10,000 zgjedhës”. Ajo ka shfuqizuar gjithashtu si të papajtueshëm me Kushtetutën edhe fjalinë e nenit 71 të Kodit Zgjedhor ku thuhet: “Zgjedhësit depozitojnë në mënyrë individuale nënshkrimet e tyre për mbështetjen e kandidatit të propozuar nga një grup zgjedhësish apo për partitë dhe koalicionet e parashikuara në nenet 68 dhe 69 të këtij Kodi, në KQZ apo përpara noterit”.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Gjykata Kushtetuese, veç të tjerave arsyeton se midis partive dhe kandidatëve duhet të krijohen shanse të barabarta (strikte ose proporcionale). (Për hollësi të mëtejshme shih vendimin Nr.32 datë 15/12/2009 të Gjykatës Kushtetuese.)

Në përfundim, e shikojmë të nevojshme të përmendim edhe një problem tjetër mjaft të rëndësishëm që nuk përmendet në rekomandimet e OSBE/ODHIR-it, por që ka krijuar konflikt dhe gjendje të acaruar brenda KQZ-së dhe që është reflektuar edhe në partinë më të madhe opozitare. Ky konflikt është diskutuar dhe debatuar në vazhdim, madje është konsideruar edhe si burim i acarimit të klimës politike dhe si një nga shkaqet e kërkesës për ngritjen e Komisionit Parlamentar që do të hetonte Zgjedhjet e 28 Qershorit 2009.

Është fjala për nenin 138 të Kodit Zgjedhor ku thuhet se, kur dy anëtarë të KQZ-së kërkojnë rinumërimin dhe ose rivlerësimin e votave të caktuara, KQZ-ja është e detyruar ta përmbushë këtë kërkesë. Në fakt, KQZ-ja ka vlerësuar (ka hyrë në çmimin) e kësaj kërkesë dhe ka vendosur refuzimin e saj me arsyetimin se nuk ka patur kontestime gjatë numërimit të votave. Ky arsyetim ose ky interpretim mendojmë se nuk ka qenë i drejtë. Përmbajtja e ligjit ishte kategorike; KQZ-ja në këtë rast duhet detyrimisht të bënte rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave. Pavarsisht nga fakti se kjo çështje u shqyrtua edhe nga Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit që i dha të drejtë KQZ-së, për të parandaluar çdo lloj mosmarrëveshje apo konflikt në zgjedhjet e 8 Majit 2011, do të sugjeronim që dispozita e mësipërme të rishikohej dhe të formulohej në mënyrë të atillë që të mos lihej asnjë shteg çmimi apo interpretimit nga KQZ-ja, madje do të sugjeronim të shtoheshin fjalët “kjo kërkesë nuk i nënshtrohet procesit të votimit”.

Botimi i këtij materiali është mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë. Opinione, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.